



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 19/15/ prot:

Pukë, më 22.10.2024

VENDIM
Nr. 43, datë 16.10.2024

PËR
“MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIT PËR 8-MUJORI VITI 2024”

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" në ligjit nr.84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023",në ligjin nr. 68/2017 pika 3,neni 48 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr 22, date.30.07.2018 "Për procedurat standarte te monitorimit te buxhetit te njesive te vetqeverisjes vendore " VKB nr.47 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024",VKB nr. 08 datë 18.03.2024 (buxheti shtesë), Këshilli i bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij të datës 16.10.2024, pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise:

V E N D O S I:

1. Miratimin e Buxhetit Faktit për 8- mujorin e vitit 2024,sipas raportit dhe pasqyrave përkatëse ,bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen Vendore"
4. Vendimi u shpall me date 18.10.2024.
Vota te vlefshme gjithsej 12
Vota pro 12, vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI
Hazbi Terbuni

KRYETARI
Gjon GJOKA





04.11.24

shprehur me 1 votë + sek. Këshillit



19.15/3
04.11.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.726/1 prot.

Shkodër, më 01.11.2024



Lënda: Mbi Vendimin Nr. 43, datë 16.10.2024 të Këshillit të Bashkise Pukë.

KESHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, neni 8, shkronja “a”, neni 22, pika 1/1, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, nenet 54/n, 55/3 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 48, të ligjit Nr.9963, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 65, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.22, datë 30.07.2018 “Per procedurat standarte të të monitorimit të buxhetit të njesive të qeverisjes vendore”, pika 13, të Udhëzimit të MFE Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të VKB Pukë Nr.47, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Pukë për vitin 2024”, të shkresës së Këshillit të Bashkisë Pukë nr.1896/3prot., datë 22.10.2024, *shqyrtoi VKB Pukë nr.43 datë 16.10.2024 “Mbi miratimin e buxhetit faktik për 8-mujorin, viti 2024”.*

Prefekti ju sjell në vëmendje zbatimin e pikës 1 të nenit 48 të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, i cila shpreh se KB miraton jo më pak se tre raporte 4 mujore.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm si një vendim me karakter njohës, informues për KB mbi aktivitetin financiar të bashkisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

